



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 janar 2013
Nr. ref.: RK349/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI65/11

Parashtruesi

Holding Corporation “Emin Duraku”

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041, të datës 27 prill 2011, të
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të
bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Holding Corporation “Emin Duraku” nga Gjakova, përfaqësuar nga z. Myrteza Duli, me banim në Gjakovë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Urdhrin SCC-0041 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme), të datës 27 prill 2011, në pajtim me të cilin parashtruesit i është kërkuar të sigurojë përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve.
3. Rrjedhimisht, parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e nenit 25.7 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2008/6, për ndryshimin dhe zëvendësimin e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2006/17, për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2002/13, Mbi Themelimin e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi Çështjet që Lidhen me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: UNMIK, UA 2008/6).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) i kushtetutshmërisë së Urdhrit SCC-0041 të Dhomës së Posaçme, të datës 27 prill 2011, i cili ishte i lëshuar në bazë të nenit 25.7 të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut, Nr. 2008/6.
5. Gjithashtu, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës dhe në pajtim me nenin 41 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës kërkon kompensim në vlerën 20.000 euro.

Baza juridike

6. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i datës 15 janar 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

7. Më 9 maj 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesë në Gjykatë.
8. Më 17 gusht 2011, Kryetari emëroi gjykatësin Altay Suroy Gjykatës raportues. Po këtë ditë, Kryetari emëroi edhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.
9. Gjithashtu, më 17 gusht 2011, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese e njoftoi Dhomën e Posaçme për kërkesën e parashtruesit.
10. Më 24 shtator 2012, Sekretariati i Gjykatës e pyeti parashtruesin e kërkesës si dhe Dhomën e Posaçme për gjendjen e rastit të parashtruesit të kërkesës në Dhomën e Posaçme.
11. Më 29 shtator 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës informoi Gjykatën se rasti është ende në pritje në Dhomën e Posaçme.
12. Dhoma e Posaçme, nëpërmjet letrës së saj të datës 2 tetor 2012, informoi Gjykatën se seanca për shqyrtimin e rastit të parashtruesit të kërkesës është caktuar për t'u mbajtur më 12 tetor 2012.

13. Më 21 nëntor 2012, Kolegji shqyrtues, pasi shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues, i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Faktet e rastit, siç janë paraqitur nga parashtruesi i kërkesës dhe që mbështeten nga dokumentet, mund të përmbliidhen si në vijim:
15. Me datë të pacaktuar parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Dhomën e Posaçme padinë kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP).
16. Më 27 prill 2011, Kolegji gjykues i Dhomës së Posaçme, në bazë të nenit 28.4 të Udhëzimit Administrativ të UNMIK-ut 2008/6, në pajtim me nenin 25.7, lëshoi Urdhrin SCC-0041, e datës 27 prill 2011, me të cilin parashtruesit të kërkesës i kërkohet që në afatin kohor 7-ditësh të sigurojë përkthimin në gjuhën angleze të të gjitha dokumenteve, të lutjes së shkruar si dhe të dokumenteve mbështetëse.
17. Më 4 maj 2011, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës paraqiti kërkesë për shtyrjen e afatit kohor 7-ditësh, me arsyetimin se, për shkak të pamundësisë financiare dhe logjistike, parashtruesi i kërkesës është duke hasur në vështirësi për të organizuar përkthimin e dokumenteve.
18. Përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës gjithashtu arsyetoi se kërkesa e Urdhrit të kontestuar *“është e pakuptueshme dhe e paqartë për arsye se sipas Kushtetutës gjuha shqipe është gjuhë zyrtare në Kosovë,... dhe se një akt i quajtur Urdhëresë Administrative nuk mund të jetë mbi Kushtetutën...”*.
19. Sidoqoftë, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës konfirmoi qëllimin e tyre për të plotësuar kërkesën e Urdhrit të kontestuar dhe të dorëzojë dokumentet e përkthyer në Dhomën e Posaçme.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 25.7 i UA të UNMIK-ut 2008/6 është në shkelje të nenit 5 [Gjuhët]; të nenit 7 [Vlerat; mosdiskriminimi]; të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme], të nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut]; të nenit 24 [Barazia Para Ligjit]; të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës; dhe të nenit 6 [E Drejta për Gjykim të Drejtë], në pajtim me nenin 14 [Ndalimi i Diskriminimit] të KEDNJ-së.
21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se nuk është në dijeni të ndonjë rasti në botë, ku pala detyrohet t'i drejtohet gjykatës në një gjuhë jozyrtare. Fakti se kërkesat e paraqitura në gjyq duhet të përkthehen në gjuhën angleze, me shpenzimet e palës që paraqet kërkesat, përkundër dhe krahas gjuhëve zyrtare, është një padrejtësi themelore.
22. Për më tepër, në bazë të nenit 53 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 41 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Republika e Kosovës që t'i paguhen 20.000 euro dëmshpërblim për dëmet që parashtruesi i kërkesës pretendon t'i ketë pësuar.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

23. Fillimisht, Gjykata do të dëshironte të përsëriste se mund të vendosë për pranueshmërinë e një kërkesë vetëm nëse parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në fuqi, të cilat janë në dispozicion nën ligjin e zbatueshëm në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës dhe të nenit 47.2 të Ligjit, që përcaktojnë:

neni 113.7 i Kushtetutës: “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”...

neni 47.2 i Ligjit: “Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Shkaku themelor për rregullimin e shterimit është që t'u japë mundësi autoriteteve përkatëse, duke përfshirë edhe gjykatat, për të parandaluar apo për të përmirësuar shkeljen e pretenduar të Kushtetutës. Ky rregull bazohet në supozimin se sistemi juridik i Kosovës do të ofrojë kompensim efikas për shkeljen e të drejtave kushtetuese. Ky është një aspekt i rëndësishëm i natyrës plotësuese të Kushtetutës (Shih, *Aktvendim për papranueshmëri: Universiteti AAB-RIINVEST sh.p.k. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, KI-41/09, i datës 21 janar 2010; dhe, shih, mutatis mutandis, KEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendimi i datës 28 korrik 1999*).
25. Në rastin aktual, Gjykata gjen se rasti i parashtruesit të kërkesës është ende në pritje në Dhomën e Posaçme dhe se shqyrtimi i rastit është planifikuar për datën 12 tetor 2012.
26. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme nën ligjin e zbatueshëm, siç kërkohet nga neni 113.7 i Kushtetutës dhe nga neni 47 (2) i Ligjit.
27. Për sa i përket kërkesës së parashtruesit për të shqyrtuar kushtetutshmërinë e UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6, Gjykata thekson se vetëm palët e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës kanë të drejtë të parashtrojnë pyetjen e përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk është një palë e autorizuar sipas nenit 113.2 të Kushtetutës (Shih, *Aktvendim për papranueshmëri Sami Burnjaku, Shqyrtimi kushtetues i Vendimit të Kolegjit Gjyqësor të Dhomës së Posaçme, SCC 10-0079, i datës 21 janar 2011 dhe kushtetutshmërisë së Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut Nr. 2008/6..., Rasti nr. KI34/11, i datës 8 dhjetor 2011*).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe në pajtim me rregullin 36 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Altay Suroy



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani